

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	626-23-991-2-2-1
Nr i brendshëm	626-23-002-2-2-1

Sa i përket tenderit për : “Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GeoFIX SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtinë, Rr. Vicianum Veranda C2.7, Hy.1, Lok.3/A Arberia 3

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

045-663-660

(Numri Telefonit)

10 000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Ilir Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Geofix1@gmail.com

(Adresa elektronike)

17.04.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë është bërë me datë : 22.02.2023
Afati i fundit për dorëzim të tenderit : 15.03.2023 ora 14:00
Procesverbali i hapjes së tenderit është bere me date : 15.03.2023 ora 14:00 permes sistemit te e-prokurimit
Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët në bazë të poentimit
B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-s dhe letrat standarde me date : 13.04.2023 ora 14:21
Kërkesën për Rishqyrtim e bejme me datë : 16.04.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderit eshte bere me date : 15.03.2023 ne ora 14:00 , procesverbalin e kemi te ngarkuar permes sistemit te e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Përmes vlerësimit te tenderëve dhe eliminimit te pa përgjegjshëm te Operatorit Ekonomik **GeoFIX SH.P.K.** , AK- **KOMUNA E MAMUSHËS** ka bërë shkelje të rëndë te dispozitave ligjore, si ne vijim:

- **Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092**
 - Neni 1 Qëllimi
 - Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
 - Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
 - Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
 - Neni 61 i LPP-se **Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**
 - Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- **LEGJISLACIONI SEKONNDAR/ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP).**
 - Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
 - Neni 38 i RRUOPP per Sqarime i Tenderëve

Me datë 13.04.2023 autoriteti kontraktues **KOMUNA E MAMUSHËS** ka nxjerr vendimin e autoritetit kontraktues përmes formularit standard B58 Njoftim mbi Vendimin e AK-së - dhe Letrën Standarde mbi Tenderuesit e Eliminuar përmes formularit B42 ku Operatorit Ekonomik **GeoFIX SH.P.K.** është shpallur i pa përgjegjshëm me arsyetimin si ne vijim, arsyetimi i cili nuk qëndron i bazuar ne Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik-RRUOPP.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2. • Lista e punëtorëve të O.E. •Diplomat përkatëse të punëtorëve dhe inxhinierëve të paraqitur në listë sipas kërkesës •CV-ja e punëtorëve dhe inxhinierëve e nënshkruar nga vetë personi (origjinal ose kopje e noterizuar) • Kontratat valide të punës - Kopje.

Ju keni dorëzuar listën e stafit dhe diplomat e inxhinierëve të kërkuar mirëpo CV-ja e inxhinierit Ibrahim Junuzi e paraqitur nga ana juaj, nuk është nënshkruar nga vetë inxhinieri sikur është kërkuar më lartë andaj CV-ja nuk e ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023, ne paraqitjen tabelore është paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, andaj tenderi juaj refuzohet si i papërgjegjshëm.

Operatori Ekonomik **GeoFIX SH.P.K.** pas marrjes se Letrës Standarde mbi Njoftimin e Tenderuesit te Eliminuar dhe Vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës 13.04.2023, ku nuk jemi pajtuar me arsyet e eliminimit dhe me datë 16.04.2023 kemi bërë Kërkesën për Rishqyrtim sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe te cilën e kemi dërguar tek Autoriteti Kontraktues **KOMUNA E MAMUSHËS** përmes platformës elektronike te prokurimit publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë 13.04.2023 autoriteti kontraktues **KOMUNA E MAMUSHËS** ka nxjerr vendimin e autoritetit kontraktues përmes formularit standard B58 Njoftim mbi Vendimin e AK-së - dhe Letrën Standarde mbi Tenderuesit e Eliminuar përmes formularit B42 ku Operatorit Ekonomik **GeoFIX SH.P.K** është shpallur i pa përgjegjshëm me arsyetimin si ne vijim, arsyetim i cili nuk qëndron i bazuar ne Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik-RRUOPP.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2. • Lista e punëtorëve të O.E. •Diplomat përkatëse të punëtorëve dhe inxhinierëve të paraqitur në listë sipas kërkesës •CV-ja e punëtorëve dhe inxhinierëve e nënshkruar nga vetë personi (origjinal ose kopje e noterizuar) • Kontratat valide të punës - Kopje.

Ju keni dorëzuar listën e stafit dhe diplomat e inxhinierëve të kërkuar mirëpo CV-ja e inxhinierit Ibrahim Junuzi e paraqitur nga ana juaj, nuk është nënshkruar nga vetë inxhinieri sikur është kërkuar më lartë andaj CV-ja nuk e ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023, ne paraqitjen tabelore është paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, andaj tenderi juaj refuzohet si i papërgjegjshëm.

AK- KOMUNA E MAMUSHËS me vendimin e vet te dates 13.04.2023 duke na eliminuar ne si operator ekonmik me çmim me te ulet nga poentimi dhe i pergjegjshem nga ky aktvitet i prokurimit ka bërë shkleje te rende te dispozitave ligjore te Ligjit pe Prokurim Publik , saktesisht te neneve perkatese si ne vijim:

Neni 1 i LPP-së Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
- Përmes vlerësimit jo të drejtë dhe eliminimit nga aktiviteti i prokurimit të Operatorit Ekonomik **GeoFIX SH.P.K, AK- KOMUNA E MAMUSHËS** ka bërë shkelje të rëndë të këtij neni duke eliminuar Operatorin Ekonomik padrejhtësisht nga aktiviteti i prokurimit edhe pse oferta jonë ka çmimin më të lirë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë dhe në këtë mënyrë **AK-KOMUNA E MAMUSHËS** nuk ka bërë mënyrën më efektive dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Eliminimi ynë në këtë rast është në kundërshtim të plotë me qëllimin e prokurimit të përcaktuar sipas neni 1 të LPP-së.

Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Përmes vlerësimit jo të drejtë dhe eliminimit nga aktiviteti i prokurimit të Operatorit Ekonomik **GeoFIX SH.P.K, AK- KOMUNA E MAMUSHËS** ka bërë diskriminim dhe trajtim jo të barabartë të ofertuesve duke eliminuar konkurrencën dhe transparencën që janë parimet kryesore të Ligjit për Prokurim Publik dhe njëkohësisht duke e keqpërdorë në total këtë aktivitet.

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1.Paragrafi 2 i neni 59 të LPP-së në mënyrë shumë të çartë e thekson, citat paragrafi “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose

pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. AK-KOMUNA E MAMUSHËS edhe pse ka zbatuar këtë paragraf ka kërkuar nga ne me letren standarde për sqarimin e tenderit edhe perkunder që ne i kemi derguar me profature artikujt të cilet na ka kërkuar sqarim AK prap se prap ne jemi eliminuar dhe ne këtë mënyrë ka bërë shkelje të LPP-së saktësisht të paragrafit 2 të neni 59 të LPP-se.

-AK ketu ka bere shkelje ligjore duke mos na kerkuar sqarim ashtu siq citohet ne kete nen te LPP-se por vetem na ka diskriminuar duke na eliminuar pa asnje arsye apo me arsyjen qe e kane cekur ne vendim qe nuk qendron sepse eshte arsyetim i ulet ajo arsye qe na kane eliminuar sepse sipas LPP-se dhe Neneve ne fuqi AK ka mundur te kerkoje sqarime nga ne , me kete AK e tregon shkeljen ligjore

Neni 61 i LPP-se Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Kerkesa e jonë si operator ekonomik është se oferta e jonë te trajtohet ne perputhje me këtë paragraf 4.6.1 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim. Ne kemi gene operatori ekonomik qe kemi vendosur cmimi reale te tregut dhe Cmimores ne fuqi qe e kemi .

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

- **LEGJISLACIONI SEKONДАР/ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP). RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të

kërkohe, ofrohet ose lejohet.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontrate.

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

Autoriteti Kontraktues KOMUNA MAMUSHE nepermjete vleresimit te ketije tenderi ka bere shkelje ligjore te dispozitave te LPP-se ne fuqi duke na eliminuar neve si OE i cili ka ofruar cmimin reale te tregut dhe konform cmimores qe e kemi te aprovuar dhe kemi qene OE i pergjegjshem , por AK nepermjet komisionit vleresues i cili nuk eshte thirrur sipas ligjit ne tendencen e eliminimit ka bere shkelje ligjore , sepse arsyetimin te cilin e ka dhene AK ne vendimin e tyre nuk qendron ku ne ju argumentojme me poshte se konform ligjit eshte dashur te kerkohet sqarim nga ne per te plotesuar ate dokument i cili nuk ka munguar dhe nga i cili nuk do te kishte modifikim te dosjes apo ndryshim pra eshte dokument i cili nuk luan rendesin e nderhyrjes.

Ju lutemi shikojeni me poshte konform **LEGJISLACIONI / LEGJISLACIONI SEKONNDAR**

[A02 Udhezues Nr-001/2023 per prokurimin publik](#) 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK		
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve		
10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së		
Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohe informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohe informata sqaruese	69

Referojuni me larte pikes 10 Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve , vetem shikojeni qfare shkelje keni bere edhe po te kishte munguar CV-ja ju eshte dashur te kerkoni informata sqaruese konform nenit 69 , ju jeni gabim te pretendimi juaj qe na keni eliminuar . Vetem ju lutemi shikojeni CV-ja e dorezuar nuk permban informatat e

kerkuara ju keni mundur te kerkoni informata sqaruese konform nenit 60 te LPP-se sepse aty ka qene vetem nje nenshkrim i thjeshte qe nuk e ka nenshkruar CV menaxheri nuk ka qene diqka e madhe e cila nuk mund te permiresohet ju CV e keni pasur me gjitha te dhenat dhe ashtu siq eshte kerkuar . Por ju per arsyje se nuk ju ka dalur i pergjegjshem ndonje OE i favorizuar ju me kete arsyetim te pa drejte diskriminues dhe jo sipas ligjit na keni eliminuar .

Kërkojmë nga AK- KOMUNA E MAMUSHËS qe sipas dispozitave ligjore te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, te aprovoj Kërkesën për Rishqyrtim si te BAZUAR dhe te bëjë korrigjimet e nevojshme te njoftimit për kontratë dhe te dosjes se tenderit për këtë aktivitet te prokurimit.

Ne te kunderten nese nuk merrni ju nje vleresim te drejte jo diskriminues dhe nese nuk na kthehet nje pergjigje pozitive dhe si te bazuar ne jemi te detyruar te bejme ankesen ne OSHP sepse nuk e lejojme te na behet kjo pa drejtesi , pra do te shfrytezojme gjitha instancat dhe te derjtat konform ligjit qe na jepen mos te lejojme qe ne kete menyre te diskriminohemi nga ky vleresim jo i drejte .

Me Respekt
GEOFIX SHPK

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përmes mos bërjes se korrigjimeve te kerkuara ne si operator ekonomik konstatojmë se jemi te diskriminuar nga pjesëmarrja ne këtë aktivitet te prokurimit dhe si rrjedhojë e këtij nën kriteri te poentimit do te këtë edhe dëmtim te vlerës për para nëse nuk merren për bazë korrigjimet sipas kërkesës sonë.

Nga ky aktivitet i prokurimit operatorit ekonomik **GeoFIX SH.P.K.** i është shkaktuar dëmi si ne aspektin material dhe moral:

- Marzha e Fitimit te humbur
- Kostoja e përgatitjes se kerkeses per rishqyrtim si dhe
- Shpenzime tjera administrative

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit
- c) një kopje të kërkesës për sqarime të bërë nga OE date : 03.04.2023
- d) përgjigjja e AK-se në kërkesën për sqarime e datës 04.04.2023
- e) një kopje të kërkesës për sqarime të bërë nga OE date : 07.04.2023
- f) përgjigjja e AK-se në kërkesën për sqarime e datës 12.04.2023
- g) Kërkesa për rishqyrtim është bërë me date : 17.04.2023